


REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEÇ/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6812 Nr. i faq/Br.str/No.pg 184
Data/Datum/Date 24 / 12 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



Dhjetor 2025



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

HYRJE

Të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit,

Kemi kënaqësinë të paraqesim para jush një informatë për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën janar - dhjetor 2025, si dhe ecurinë e implementimit të projekteve kapitale në komunën e Rahovecit gjatë kësaj periudhe.

Sukseset tona të deritanishme nuk kanë qenë pa sfida dhe pa barriera, besojmë se suksesi ynë më i madh i përbashkët ka qenë tejkalimi i sfidave e i barrierave në favor të qytetarit rahovecas. Me bashkëpunim të ndërsjellë, me mirëkuptim dhe punë të palodhura ne kemi arritur që në këtë periudhë që po e lëmë pas të realizojmë me sukses një sërë projektesh që janë jetike për të ardhmen e Komunës së Rahovecit. Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale.

Informata që po e paraqesim sot përfshin detaje nga këto të arritura dhe suksese të qeverisjes sonë.

FJALA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Të nderuar bashkëqytetarë!

Tash kur është bërë një periudhë nga qeverisja jonë, qyteti që drejtojmë me të cilin bashkë ndajmë fatin tonë çdo ditë, me patjetër mund të konstatojmë se ka marr një dimension të ri zhvillimi e shprese në çdo kënd të trupit të territorit të tij. Jo nga rastësia, as nga vetzhvillimi, por nga punët publike që janë në vlim përgjatë gjithë territorit të komunës së Rahovecit, e nga vullneti këmbëngulës i rahovecianëve për t'i dhënë ngjyrë zhvillimi çdo pjesë të territorit tonë. Kudo në lagje, rrugë publike, kënde rekreacioni, fshatra e kthina të qytetit e fshatit, po vendosim dorën në projekte që për dekada kanë vuajtur mungesën nga vet qytetarët. Ato natyrisht, nuk do të ishin të prekshme, konkrete e shërbyese të qytetarëve pa një vullnet të hekurt që ta bëjmë Rahovecin më të mirë në çdo kënd të tij. Suksesi padyshim nuk është vetëm një fjali që duan ta dëgjojnë të gjithë. Është një përpjekje shumëjavore, konstante e vullnetplotë për ta bërë ndryshimin në secilën fushë ku lypset kompetenca jonë vendimmarrëse. Edhe kjo përmbledhje në vijim është një storie suksesi. Është

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



përmbledhja e djersës së qindra punonjësve të administratës komunale që shërbimet për qytetarin të kenë gjithmonë cilësinë e nevojshme e shpejtësinë maksimale. Kjo është pasqyra sesi unë bashkë me ekipin tim për secilën ditë të punës sonë gjatë vitit të parë të qeverisjes në këtë mandat, ndonëse edhe pa sfida nuk shpëtuam, arritëm t'ia dalim, në përmbushje të objektivave qeverisëse e vizionit për transformimin e Rahovecit të nisur qysh nga fillimi i qeverisjes sonë.

ZOTIMET

- Komunë e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejt dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë që u shërben qytetarëve pa dallim;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Komunë ku promovohen politikat dhe praktikat më të mira, si dhe standardet e larta të qeverisjes;
- Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;
- Komunë pa diskriminim, e që qytetarët i trajton barabartë;
- Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;
- Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri;
- Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevoja të veçanta;
- Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identitet i Rahovecit;
- Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;
- Komunë ku përkushtimi për të vepruar ndershëm dhe në pajtim me ligjin, veçse vullnet, përcaktim i të zgjedhurve, jetësohet edhe si detyrim moral ndaj zgjedhësve si dhe ndaj ligjit;
- Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;
- Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

- Bujqësia;
- Ekonomia, agroturizmi dhe punësimi;
- Administrata dhe transparenca;
- Arsimi;
- Shëndetësia dhe përkujdesja sociale;
- Infrastruktura, urbanizmi dhe mjedisi;
- Barazia gjinore;

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

- Investimet nga fondi i eficiencës së energjisë në sektorin publik dhe privat;
- Investime në modernizimin e infrastrukturës kulturore, sportive dhe hapësirave për të rinjtë, si dhe rritja e përkrahjes për këta sektorë;
- Promovimi i potencialit dhe i mundësive për investime nga mërgata jonë;
- Investime në modernizimin dhe digjitalizimin e shërbimeve komunale;
- Mbrojtja e vlerave të luftës dhe trashëgimia kulturore historike.

PRIORITETET PËR VITIN 2026

- Përfundimi i Sheshit Qendror të Qytetit;
- Përfundimi i Ballkonit panoramik;
- Përfundimi i Qendrës për Kulturë, Rini, Art dhe Inovacion;
- Funksionalizimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i hapësirave publike;
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i vlerave kombëtare historike dhe i luftës çlirimtare (komplekset përkujtimore, muzetë, monumentet e trashëgimisë kulturore historike, lapidarët, varrezat e dëshmorëve dhe të martirëve etj);
- Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve shkollore;
- Rritja e përkrahjes për 50% (nga 500 euro sa është tash, në 750 euro) për çdo lindje në maternitetin e Rahovecit;
- Rritja e numrit të përfituesve dhe e vlerës financiare të bursave për studentët dhe nxënësit e dalluar të komunës,
- Bibliotekat - kujdes i shtuar për bibliotekat, duke u përkujdesur për blerjen e titujve të rinj, por edhe duke i mirëmbajtur dhe investuar në objektet e bibliotekave ekzistuese;
- Laboratorë dhe kabinete - do të investojmë në zhvillimin dhe krijimin e laboratorëve të rinj për shkencat natyrore dhe në kabinete;
- Sigurimi shëndetësor për fëmijët në çerdhe;
- Tabela digjitale në shkolla;
- Projekte dhe investime konkrete për digjitalizimin e bujqësisë;
- Rrugë fushore të reja dhe mirëmbajtje e rrugëve ekzistuese;
- Përkrahje për fermerët me farëra dhe inpute bujqësore;
- Sisteme të ujitjes nga burime alternative;
- Krijim i kushteve për operim të bizneseve lokale (infrastrukturë në përputhje me PZhK-në dhe HZK-në);
- Punë praktike me pagesë për të rinjtë;
- Shërbime veterinarë periodike falas;
- Konsulencë dhe hartim të projekteve falas për bujq dhe biznese;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtje e rrugëve ekzistuese;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj.;
- Bashkëpunim me KRU "Gjakova" dhe me donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Zgjerim i bashkëpunimit me qendrat grumbulluese dhe përpunuese të perimeve dhe të rrushit;
- Eficienca e energjisë në objekte publike dhe në sektorin privat, përmes fondeve të huaja;
- Mirëmbajtje e rregullt e hapësirave publike, e objekteve publike dhe e të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

- Investime të tjera në kanalizimin e ujërave të zeza dhe në disa rrugë në pjesë problematike të qytetit;
 - Kënde lojërash për fëmijë;
 - Rritje e numrit dhe e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit sa më të mirë dhe profesional;
 - Rritje e përkrahjes në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit, përmes përkrahjes së të rinjve, shoqatave kulturore-artistike dhe klubeve sportive;
 - Rritje e subvencionimit për projekte kulturore-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
 - Vazhdim i zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2026-2030;
 - Përkrahje dhe lehtësira për prodhuesit, për tregtinë, për zejet e veçanta, për artizanalet etj.;
 - Trajtim dhe rregullim i shtretërve të lumenjve dhe të përrenjve;
 - Plotësim-ndryshimi i rregulloreve të Komunës së Rahovecit;
 - Rritja e kapaciteteve inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, për të parandaluar e mbrojtur nga ndotësit e shkatërruesit e tij, me shqiptim të gjobave mandatore;
 - Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne;
 - Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë;
 - Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit;
 - Realizim i planit të të hyrave komunale;
 - Promovimi dhe përmirësimi i mjedisit të Rahovecit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre, si dhe për ato të reja;
 - Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm;
 - Bashkëpunim me OJQ-të, bizneset dhe grupet e interesit.
- SYNIMET PËR VITIN 2026
- Politika të favorshme për investitorët nga mërgata dhe investitorët në sektorin e energjisë së ripërtëritshme;
 - Përkrahje për bizneset lokale me hapësira të reja, me inkubatorë dhe bashkëfinancim të ideve të reja të biznesit, me fokus bizneset që udhëhiqen nga gratë dhe të rinjtë;
 - Mbështetje e bujqësisë me teknologji të mençur për të rritur prodhimin dhe përfitimet për fermerët;
 - Mirëmbajtje dhe hapje e rrugëve fushore për qarkullim dhe qasje më të lehtë për fermerët në pronat e tyre bujqësore;
 - Mbështetje për fermerët me subvencione për farëra, plehra dhe makineri bujqësore;
 - Mbështetje grave dhe vajzave për aftësim profesional, trajnime në fushën e teknologjisë informative dhe në fushëveprimtari të tjera me interes, si dhe mbështetje të fushatave ndërgjegjësuere për barazinë gjinore;
 - Pastrim i ujërave, i përrenjve dhe ndërtim i gropave septike (impianteve) për trajtimin e ujërave të zeza;
 - Eliminimi i deponive ilegale, duke caktuar lokacione të përshtatshme të deponive legale;
 - Krijim i mundësive për investitorë që merren me riciklimin dhe trajtimin e mbeturinave;
 - Në bashkëpunim me donatorët, do të angazhohemi për zgjerimin e sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon;

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

- Përfundimi i ndërtimit të shkollave të reja;
- Zgjerim i listës së barnave esenciale;
- Aparate EHO për QMF-të;
- Mbështetje dhe punësim për mjek të rinj;
- Trajnim i vazhdueshëm i stafit mjekësor në shtetet partnere;
- Modernizim i shërbimeve stomatologjike dhe diagnostike;
- Investime në rritjen e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e tyre, pajisje mjekësore dhe inventarizim për QKMF-në dhe rrjetin e shërbimeve parësore shëndetësore;
- Arsimit cilësor dhe biblioteka, pajisje bashkëkohore, laboratorë, më shumë teknologji informative dhe mjete konkretizimi në shkolla;
- Zhvillim ekonomik dhe punësim nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së sektorit privat;
- Investime për zhvillimin e agroturizmit;
- Rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale;
- Funksionalizimi i qendrës së magazinimit – depos bujqësore;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe me Drejtorinë për Punë inspektuese, legalizimi i objekteve pa leje dhe respektimi i ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje;
- Vazhdimi i evidentimit dhe i lirit të pronave të uzurpuara;
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera;
- Projekte me partneritet publiko-privat;
- Hartimi i planeve, nxjerrja e akteve dhe e rregulloreve të tjera;
- Zhvillimi i Rahovecit në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe menaxhimi i burimeve fizike bazuar mbi parimet e shëndosha mjedisore, si dhe mbi parimet e partneritetit me mekanizma vendorë e ndërkombëtarë, për realizimin e vizionit për komunë model me një qeverisje cilësore, efikase dhe llogaridhënëse;
- Vazhdimi i trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe të përrenjve, përmes investimeve kapitale nga komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit.

SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2026

- Buxheti i ulët i Qeverisë së Kosovës, mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare nga qeveria qendrore, si trend i vazhdueshëm në Kosovë, që i bën investimet edhe më të vështira (angazhime të shtuara në kërkesa nga qeveria qendrore);
- Integrimi i sa më shumë qytetarëve dhe thellimi i bashkëpunimit të ngushtë me organizatat joqeveritare (OJQ-të), bizneset, zanatlinjtë, tregtarët, bujqit, shoqërinë civile etj.;
- Mungesa e hapësirave publike në territorin e komunës së Rahovecit;
- Mungesa e burimeve të nevojshme njerëzore dhe profesionale;
- Përfshirja më e madhe e qytetarëve tanë në aktivitetet tona dhe duke i mbajtur ata të informuar për zhvillimet në komunën tonë.

Një moment historik u shënua sot në Rahovec, me pritjen e delegacionit të Bashkësisë Shqiptare të Bosnje dhe Hercegovinës, të përbërë nga profesorë dhe studiues të shquar, të udhëhequr nga znj. Elvira Dushi.

Ky delegacion vizitoi për herë të parë Republikën e Kosovës pa viza, një arritje që simbolizon lidhjet e forta dhe lirinë e lëvizjes mes shqiptarëve.



Përurohet kabineti i ri i informatikës në Shkollën fillore “Isa Boletini”



Kryetari Latifi së bashku me Drejtorin e Arsimit, nënkryetarin dhe bashkëpunëtorë të tjerë, morën pjesë në ceremoninë e përuimit të hapësirës së dedikuar për kabinetin e informatikës në objektin e Shkollës Fillore "Isa Boletini". Krijimi i kësaj hapësire dhe pajisja me kompjuterë e këtij kabineti u mundësua si rezultat i angazhimit dhe financimit të Këshillit të Prindërve në bashkëpunim me Komunën. Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e kushteve për mësimdhënie dhe mësimnxënie në fushën e teknologjisë informative.

Komuna e Rahovecit dhe Drejtoria e Arsimit do të vazhdojnë të mbështesin çdo iniciativë që kontribuon në përmirësimin e kushteve për mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke siguruar që nxënësit të kenë mundësi të barabarta për zhvillimin e aftësive të tyre në fushën e teknologjisë.


INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

Kujtohen dëshmorët e kombit në 35-vjetorin e rënies së tyre heroike

Në kuadër të manifestimit tradicional kulturor dhe përkujtimor “Flaka e Janarit”, Kryetari Latifi organizoi aktivitete solemne për të nderuar dëshmorët e kombit: Nesimi Elshani, Agron Fetahu, Halim Hoti dhe Hilmi Krasniqi, në përvjetorin e 35-të të rënies së tyre heroike.

Në Qendrën e Kulturës “Mensur Zyberaj”, me pjesëmarrjen e familjarëve të dëshmorëve, bashkëluftëtarëve, qytetarëve dhe personaliteteve të shquara të çështjes kombëtare, u mbajt një koncert-homazh me muzikë klasike. Artistet Besiana Mehmedi dhe Adelina Paloja, me zërat e tyre të mrekullueshëm, shoqëruar nga pianiste Alba Muçolli, përcollën mesazhe frymëzimi dhe krenarie për sakrificën e dëshmorëve. Programi u begatua edhe nga pjesëmarrja e pianistëve Rudina Ciko dhe maestro Zhani Ciko nga Tirana.



Një moment i veçantë i këtij aktiviteti ishte ceremonia e ndarjes së “Medaljes së Lirisë” dhe Mirënjohjes së Komunës së Rahovecit për Kryetarin Ali Ahmeti. Në mungesë të tij, nderimi iu dorëzua simbolikisht Nënë Stanës, një heroinë e vërtetë e UÇK-së, nënës së tre ushtarëve të Zonës Operative të Karadakut, e cila ofroi mbështetje të paçmuar për mbi 300 luftëtarë të lirisë gjatë luftës.

Kryetari Smajl Latifi theksoi rëndësinë e kujtimit dhe nderimit të dëshmorëve të kombit, duke shprehur mirënjohje për sakrificat e tyre heroike. Ai e vlerësoi “Flakën e Janarit” si simbol të sakrificave për lirinë dhe theksoi se Rahoveci, si qendër e madhe mbarëkombëtare, përcolli mesazhe të fuqishme kombëtare gjatë aktivitetit.

Ky aktivitet ishte një përkujtim i rëndësishëm i sakrificës dhe angazhimit të shqiptarëve për lirinë dhe dinjitetin e Kosovës, duke u bërë një ngjarje e paharruar në historinë e Rahovecit dhe të kombit shqiptar.



Komuna e Rahovecit nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi me DEMOS për Transparencë dhe Pjesëmarrje Qytetare.

Kryetari Latifi nënshkroi memorandumin e bashkëpunimit me DEMOS-in, për të forcuar transparencën buxhetore dhe përfshirjen e qytetarëve në qeverisjen lokale.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



Ky partneritet do të ndihmojë në planifikimin e hershëm buxhetor, konsultimet publike dhe përdorimin e platformave digjitale.

Ai poashtu falënderoji DEMOS-in për mbështetjen në ndërtimin e një qeverisjeje më të hapur dhe më efikase për qytetarët tanë!



Kosova feston 17-vjetorin e Pavarësisë – Aktivitetet në Rahovec dhe mesazhi i Kryetarit

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 17-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, Komuna e Rahovecit organizoi një sërë ngjarjesh festive dhe solemne. Kryetari i Komunës, Kryetari z.Smajl Latifi, shprehu

krenarinë dhe angazhimin për forcimin e shtetit të Kosovë

Në mëngjes, u zhvillua një pritje tradicionale për qytetarët, ku u nderuan ata që kontribuan për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Më pas, u organizuan aktivitete kulturore dhe artistike në Qendrën për Kulturë, Arte dhe Inovacion në Rahovec, duke përfshirë ekspozita dhe shfaqje të ndryshme.

Në fjalën e tij, Kryetari theksoi rëndësinë e kësaj dite historike dhe angazhimin e Komunës së Rahovecit për zhvillimin e mëtejshëm të shtetit të Kosovës. Ai u shpreh se "Kosova është një shtet i pavarur dhe demokratik, dhe ne si qytetarë të Rahovecit do të vazhdojmë të kontribuojmë për forcimin e tij".

Në përmbyllje, u zhvillua një koncert solemn, duke shënuar kështu një ditë të paharruar për qytetarët e Rahovecit dhe të gjithë shqiptarët.

Komuna e Rahovecit vazhdon të angazhohet për zhvillimin e kulturës, arsimit, dhe infrastrukturës, duke kontribuar në forcimin e shtetit të Kosovës dhe mirëqenien e qytetarëve të saj.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



Rahovecasit nuk e harrojnë Rahovecin, kudo që ndodhen!



Kryetari i Komunës Smajl Latifi ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Forumin Anadrini (FARDI), një grup qytetarësh nga Rahoveci, që jetojnë dhe veprojnë në



Prishtinë, ai theksoi se nënshkroi një memorandum bashkëpunimi për të sjellë ide dhe projekte konkrete

në shërbim të shoqërisë sonë.

Ky partneritet synon të forcojë zhvillimin në ekonomi, në bujqësi, në kulturë dhe në rini. Komuna do të ofrojë mbështetje institucionale, ndërsa FARDI do të kontribuojë me ekspertizë dhe vizion për të mirën e përbashkët. Bashkëpunime të tilla janë dëshmi që Rahoveci ndërtohet me punë e me përkushtim, pavarësisht se ku ndodhemi. Kryetari Latifi falënderoi FARDI-n për këtë iniciativë dhe u shpreh i bindur që do të sjellë rezultate të prekshme për qytetarët e Komunës së Rahovecit!

Përmbushet edhe një zotim publik.


Kryetari Latifi, së bashku me DKA – filluan me zbatimin e projektit më të madh të digjitalizimit të materialeve mësimore në shkollat e Komunës së Rahovecit

Ky projekt është i financuar drejtpërdrejtë nga komuna jonë dhe është përmbushje e zotimeve tona për ta ngritur në nivele edhe më të larta cilësinë në arsim përmes procesit të digjitalizimit dhe përdorimit të metodave më bashkëkohore të teknologjisë dhe inovacionit për arsimim dhe edukim sa më cilësor.

Nënshkruhet marrëveshje për trajnime profesionale në administratë dhe arsim.

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •



Kryetari i Komunës së Rahovecit ka nënshkruar sot një marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorin Ekzekutiv të Institutit KAF, z. Bujar Krasniqi, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale në administratën komunale dhe në sektorin e arsimit.

Marrëveshja parasheh organizimin e trajnimeve të specializuara në fusha kyçe si



menaxhimi i financave publike, transparenca financiare, auditimi dhe menaxhimi i riskut. Një komponentë e veçantë e këtij bashkëpunimi është edhe programi "BEINT - Shkolla e Drejtorëve", që ka për qëllim përmirësimin e cilësisë në institucionet arsimore lokale.

"Me këtë hap, po investojmë në burimet njerëzore, si themel për një administratë publike më efikase dhe për një sistem arsimor më të fortë në Rahovec", u shpreh Kryetari pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Ky bashkëpunim pritet të japë rezultate konkrete në ngritjen e performancës institucionale dhe në ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

RAHOVEC I NDERON VJETORIN E EPOPESË SË UÇK-

Në përvjetorin e 27-të të Epopesë së Kosovës, sot në Kopshtin e zhvillua një ceremoni përkujtimore në rënë për liri.

Në këtë ngjarje të rëndësishme morën bashkëpunëtorë, eprorë të Policisë së Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe Rahovecit që u bashkuan për të kujtuar sakrificën e bijve dhe bijave të kombit.



HERONJTË NË 27-së

Ushtrisë Çlirimtare të Dëshmorëve në Rahovec u nderim të dëshmorëve të

pjesë bashkëluftëtarë, Kosovës dhe të Forcës së shumë qytetarë të me respekt dhe krenari

KOMUNA E RAHOVECIT DHE UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN NËN SHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR PRAKTIKË ME PAGESË

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

Kryetari Smajl Latifi së bashku me rektorin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, prof. asoc. dr. Mentor Alishani, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi për angazhimin e 5 praktikantëve me pagesë në Komunën e Rahovecit. Kjo është një mundësi për studentët që të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe një tjetër hap përpara në fuqizimin e administratës sonë.

Po investojmë në dijen dhe energjinë e të rinjve, sepse e ardhmja e Rahovecit ndërtohet me ta!

VAZHDON PROJEKTI PËR RREGULLIMIN E SHTRATIT TË LUMIT NGA RAHOVECI DERI NË FORTESË

Projekti për rregullimin e shtratit të lumit nga Rahoveci deri në Fortesë po vazhdon me hapa konkretë. Sot janë vendosur pikat gjeodezike përgjatë traseve të planifikuara, në bashkëpunim të ngushtë me gjeodetët dhe pronarët e parcelave private.



Ky është një hap i rëndësishëm teknik që i hap rrugë vazhdimin të suksesshëm të projektit, i cili ka për qëllim përmirësimin e infrastrukturës dhe mjedisit përgjatë këtij segmenti.

Komuna e Rahovecit falënderon të gjithë pronarët e tokave për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin që kanë treguar deri më tani. Duke qenë se prona publike në këtë pjesë është e kufizuar, angazhimi i banorëve dhe mbështetja e tyre është thelbësore për realizimin e punimeve në vijim.

Delegacioni I Komunës së Rahovecit viziton Këshillin Lokal të Xagħra në Maltë



Një delegacion nga Komuna e Rahovecit, i përbërë nga Kryetari i Komunës, profesori Ibish Mazreku dhe bashkëpunëtori Ruzhdi Krasniqi, ka vizituar Këshillin Lokal të Xagħra (Shara) në rajonin Gozo të Maltës. Vizita u mundësua me përkujdesjen e ambasadores jorezidente të Maltës në Republikën e Kosovës, Sh.S.S., znj. Juliana Scherri Ferante.

Delegacioni u prit nga kryetari i Këshillit Lokal të Xagħra, z. Victor Curmi, dhe shtatë anëtarët e këshillit. Gjatë takimit, kryetari Curmi njoftoi mysafirët për aktivitetet dhe festat tradicionale që zhvillohen në komunën e tij, e cila ka një popullsi prej 5,337 banorësh dhe është e njohur për

trashëgiminë e saj historike, përfshirë monumente të vjetra si Ggigantia, të cilat datojnë rreth 4000 vjet para erës sonë.

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

Nga ana e delegacionit të Rahovecit, u paraqitën mundësitë dhe vlerat që ofron Komuna e Rahovecit, duke propozuar vendosjen e një marrëdhënieje bashkëpunimi dhe binjakëzimi me Këshillin Lokal të Xagħra. Për këtë qëllim, u ftuan anëtarët e keshillit të Xagħra për një vizitë në Komunën e Rahovecit, e cila do të realizohet në fund të muajit mars të këtij viti.

Ky hap është një mundësi për të forcuar lidhjet ndërkombëtare dhe për të shkëmbyer përvoja në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

PRITJA E DELEGACIONIT NGA MALTA NË RAHOVEC – NJË LIDHJE E RE MIQËSIE DHE BASHKËPUNIMI

Në një atmosferë miqësore dhe bashkëpunuese, Komuna e Rahovecit mirëpriti një delegacion zyrtar nga Këshilli Lokal i Xagħra-s, rajoni i Gozos në Maltë. Delegacioni maltez, i udhëhequr nga kryetari Victor Curmi dhe i shoqëruar nga këshilltaret Dr. Francienne Muscat dhe Marion Portelli, u prit nga përfaqësuesit e komunës dhe profesori Ibish Mazreku, si mik dhe bashkëpunëtor i këtij takimi.

Takimi u zhvillua fillimisht në ambientet e komunës, ku u shkëmbyen ide dhe përvoja në fusha me interes të përbashkët, si bujqësia, turizmi dhe trashëgimia kulturore. U theksuan vlerat që ndajnë dy komunitetet – mikpritja, puna e palodhur dhe lidhja e fortë me traditën dhe tokën.

Delegacioni nga Malta pati mundësinë të përjetojë nga afër pasurinë kulturore dhe ekonomike të Rahovecit përmes disa vizitave domethënëse.



KOMUNA E RAHOVECIT MBËSHTET KULTIVUESIT E TRANGUJVE DHE TË SPECAVE – NËNSHKRUHET MARRËVESHJE ME “AGRO CELINA”



Komuna e Rahovecit ka ndërmarrë një tjetër hap të rëndësishëm në përkrahje të bujqësisë vendore dhe kultivuesve të perimeve, përmes nënshkrimit të një kontrate bashkëpunimi me kompaninë “Agro Celina” Sh.P.K. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është fuqizimi i fermerëve që merren me kultivimin e trangujve dhe specave, duke ofruar mbështetje konkrete dhe të strukturuar.

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •



**Nder dhe krenari për
Kombëtaren Shqiptare të
Futsallit në Rahovec**



Sot, Komuna e Rahovecit pati nderin të mirëpresë Kombëtaren Shqiptare të Futsallit, së bashku me trajnerët dhe stafin e saj. Për herë të parë, Rahoveci do të jetë nikoqir i një ndeshjeje zyrtare të futsallit, ku Palestra “Mizahir Isma” do të presë sfidën Shqipëri–Danimarkë më 12 prill 2025, në kuadër të kualifikimeve për Futsal EURO 2026.

KB “GRAPELAND” NË SUPERLIGË – KRYETARI I RAHOVECIT PRET HEROJTË E PARKETIT

Kryetari Latifi mirëpriti sot stafin dhe lojtarët e klubit të basketbollit KB “GRAPELAND”, të cilët i sollën qytetit një lajm historik: **inkuadrimit në Superligën e Kosovës në basketboll**. Kryetari e priti ekipin në një takim simbolik për të shprehur mirënjohjen dhe krenarinë e qytetarëve për këtë sukses të madh sportiv. Ai i përgëzoi për punën, disiplinën dhe përkushtimin që kanë treguar gjatë gjithë sezonit, duke theksuar se ky është vetëm fillimi i një kapitulli të ri në historinë e sportit rahovecian.



Takim i ekspertëve për zhvillimin e hotelit në Sheshin Qendror të Rahovecit

Sot, Komuna e Rahovecit organizoi një takim konsultativ me ekspertë të fushave të hotelerisë, turizmit, gastronomisë, arkitekturës dhe zhvillimit urban, për të diskutuar projektin e zhvillimit të hotelit në Sheshin Qendror të qytetit. Ky projekt synon

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



të shndërrojë këtë hapësirë në një destinacion tërheqës për vizitorët dhe një nxitës të zhvillimit ekonomik lokal.



Sot për tokën, çdo ditë për të ardhmen!

Në kuadër të Ditës së Tokës Kryetari I Komunës morri pjesë në një seri aktivitetsesh, filloi me fëmijët e çerdhës "Tulipanët" në Rahovec, ku së bashku mbollën lule dhe pemë në oborrin e çerdhës. Fëmijët, përmes këtij aktiviteti, mësojnë

rëndësinë e kujdesit për natyrën dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Më pas, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga SHL Kosova, ku bashkë me të rinjtë diskutuan për sfidat mjedisore, angazhimin e tyre dhe përkushtimin institucional për të çuar përpara projektet e gjelbra.

Pas kësaj, me bashkëpunëtorë, vizituan edhe punëtorët e Kompanisë Rajonale të Pastrimit "Ekoregjioni", të cilët po bëjnë pastrimin e hapësirave përgjatë rrugës rajonale në drejtim të Malishevës.

Çdo hap i vogël që bëjmë sot ka ndikim të madh nesër.



Përrurim në Rahovec: Rinovohen hapësirat e Kryqit të Kuq dhe HANDIKOS-it

Rahovec, 16 qershor 2025 – Janë përruruar sot renovimet e plota të hapësirave të brendshme dhe të jashtme të objekteve të Kryqit të Kuq dhe HANDIKOS-it në Rahovec, një investim që synon përmirësimin e kushteve të punës dhe shërbimeve për qytetarët ne nevojë

Punimet kanë përfshirë renovimin e ambienteve të brendshme, fasadave të jashtme, si dhe ndërrimin e dymve dhe elementeve të tjera funksionale, me qëllim krijimin e kushteve më të mira për punonjësit dhe përfituesit e shërbimeve që ofrojnë Kryqi i Kuq dhe HANDIKOS-i.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

Kjo ndërhyrje përbën pjesë të strategjisë së investimeve publike që synon rritjen e cilësisë së jetës dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë për qytetarët në nevojë në gjithë komunën e Rahovecit.

Tryezë Shkencore

“Rëndësia e organizimit të luftës së UÇK-së në ZO të Pashtrikut”

Në ambientet e Komunës së Rahovecit u zhvillua tryeza shkencore me temën “Rëndësia e organizimit të luftës së UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut”. Ngjarja mbledhi historianë, studiues, ish-ushtarë të UÇK-së dhe përfaqësues institucionalë për të analizuar nga këndvështrimi historik dhe shkencor rolin strategjik të kësaj zone gjatë luftës çlirimtare.

Kryetari i Komunës, Smajl Latifi, vlerësoi kontributin e ZO të Pashtrikut në luftën për liri, ndërsa studiuesit theksuan rëndësinë e organizimit të saj ushtarak, bashkëpunimin me popullatën dhe ndikimin në zonat përreth.



Tryeza u përmbyll me një homazh për dëshmorët dhe njoftimin për botimin e punimeve në një përmbledhje shkencore.

Vizitë në Rahovec: Projekte të reja për kulturën dhe sportin

Kryetari i Komunës së Rahovecit, së bashku me ministrin në detyrë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, vizituan Qendrën për Kulturë, Arte dhe Inovacion, ku u pa nga afër progresi i punimeve. Kjo qendër synon të jetë një hapësirë moderne për zhvillimin kulturor dhe krijues të të rinjve.

Gjatë vizitës u diskutuan edhe projektet prioritare të infrastrukturës sportive, përfshirë ndërtimin e stadiumit të qytetit, stadioneve në Krushë të Madhe, Ratkoc e Xërxë, palestrës sportive në Krushë të Madhe, sallave të edukatës fizike në disa shkolla, si dhe renovimin e Palestrës “Mizahir Isma” dhe restaurimin e objektit përkujtimor në Krushë të Madhe.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT




U theksua domosdoshmëria për nisjen e procedurave të tenderimit për stadiumin e qytetit pa vonesa. Qëllimi i përbashkët është që këto projekte të realizohen sa më parë në dobi të komunitetit.

1.5 MILION EURO INVESTIME TË REJA INFRASTRUKTURE NË RAHOVEC



Kryetari Smajl Latifi së bashku me zëvendësministrin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, z. Hysen Durmishi, nënshkruam një memorandum bashkëpunimi dhe një amendamentim të memorandumit të mëhershëm, që sjellin mbi 1.5 milion euro investime të reja infrastrukturore në komunën tonë. Përmes këtij bashkëpunimi me MMPHI-në do të bashkëfinancohen dy projekte të rëndësishme: Rregullimi i rrugës Sapniq - Nashpall, në vlerë prej 894,888.00 €; Ndërtimi i rrugës Fortesë - Celinë, në vlerë prej 650,000.00 €.

Për tri net me radhë u mbajt Festivali Folklorik “Anadrinia jehon”



Festivali mbahet në datat 11,12 dhe 13 maj, në nderim të Betejës së Anadrinit të 12 majit 1998, të mobilizimit të liridashësve të kësaj treve në luftën çlirimtare dhe është pjesë e manifestimit përkujtimor e kulturor “Java e dëshmorëve” në komunën e Rahovecit.

Në këtë edicion garues morën pjesë **18** grupe artistike nga të gjitha trevat shqiptare.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



HAPËSIRA TË REJA PARKIMI NË LAGJEN “GËZIM MULLABAZI”

Janë 38 parkingje të reja në rrugën “Gëzim Mullabazi”, në afërsi të shoqatës “Hareja”. Banorët e banesave në këtë rrugë do të kenë hapësirë të bollshme parkimi, ndërsa fëmijët do ta kenë këndin e lojërave dhe argëtimit. Në këtë mënyrë qytetit po i krijohen hapësira më të mëdha për lëvizje dhe parkim. Urbanizimi i qytetit do të vazhdojë dhe qytetarët do të kenë hapësira të reja funksionale e më tërheqëse.



Nis cikli i dëgjimeve publike për KAB 2026–2028

Është mbajtur dëgjimi i parë publik për përgatitjen e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026–2028, nën organizimin e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Buxhet dhe Financa. Në takim morën pjesë të rinj, gra, pensionistë dhe përfaqësues të komuniteteve pakicë. Grupi punues prezantoi dokumentin e ndarjeve buxhetore, i cili u shpërnda për të pranishmit. Drejtori i financave paraqiti mundësitë buxhetore për vitin 2026, ndërsa pyetjet dhe kërkesat e qytetarëve morën përgjigje konkrete dhe do të trajtohen me kujdes.

Përrurimi i rrethojës së re dhe ndriçimin modern në fushën sportive të ShFMU “Haki Stërmilli” në Retijë!

Kryetari Latifi, së bashku me bashkëpunëtorë, mësime dhënë, nxënës dhe qytetarë, përruruan rrethojën e re dhe ndriçimin modern në fushën sportive të ShFMU “Haki Stërmilli” në Retijë!

Komuna nënshkruan kontrata me 31 fermerë për serrat prej 1 ari, në bashkëpunim me Qatar Charity



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me Qatar Charity ka nënshkruar kontrata me 31 fermerë përfitues të serrave prej 1 ari. Ky projekt ofron mundësi të reja dhe kushte më të mira për prodhim bujqësor në komunë. Me një model bashkëfinancimi ku Komuna kontribuon me 25%, ndërsa partneri Qatar Charity me 75%, ky bashkëpunim po sjell rezultate konkrete për zhvillimin e bujqësisë lokale.

Kryetari mirëpret Ambasadorin e Suedisë në Kosovë

Kryetari pati kënaqësinë të mirëpresë në një takim kortezie Ambasadorin e Suedisë në Kosovë, Sh.T.Z. Jonas Westerlund. Gjatë bisedës miqësore u diskutua për zhvillimin ekonomik lokal, projektet në realizim e sipër si dhe trashëgimia kulturore e qytetit. Kryetari shprehu mirënjohje për mbështetjen dhe gatishmërinë e ambasadorit për të forcuar bashkëpunimin mes palëve.



Punimet në rrugën “Halil Hamza”

Me përkushtim dhe vizion për zhvillim, kanë nisur punimet për ndërtimin e rrugës, kanalizimit dhe instalimeve të tjera nëntokësore në rrugën “Halil Hamza”, në Rahovec, një investim i rëndësishëm për komunitetin tonë.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



Nënshkrimi i marrëveshjes me Postën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës

Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për forcimin e rendit dhe sigurisë publike, Kryetari Smajl Latifi, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Postën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës, përmes Drejtorit Rajonal të Policisë në Gjakovë, kolonelit Lumni Grashita, për shpërndarjen e gjobave të trafikut rrugor në adresat e qytetarëve.


Ky shërbim synon të rrisë efikasitetin në zbatimin e masave ndëshkuese, të përmirësojë transparencën dhe të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për respektimin e rregullave në komunikacion.



Dita e Qendrës Kulturore “Mensur Zyberaj”

Në Ditën e Qendrës Kulturore “Mensur Zyberaj”, u mbajt një fjalim solemn ku u theksua se kujdesi për trashëgiminë kombëtare është detyrim moral dhe mision atdhetar. U

nderua heroizmi i dëshmorëve, veçanërisht i Mensur Zyberajt, figurë qendrore e UÇK-së në Anadrini, dhe 32 dëshmorëve të majit. U prezantuan aktivitetet kulturore dhe përkujtimore të zhvilluara gjatë vitit nga DKRS, përfshirë “Flaka e Janarit”, “Java e Dëshmorëve”, festivalin “Anadrinia jehon” dhe “HardhFest”. U vlerësua puna e stafit të DKRS-së dhe u bë thirrje për angazhim më të gjerë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë kulturore.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

“Uta e Maleve në Rahovec”



Alpinistja e njohur Uta Ibrahim u prit nga Kryetari Latifi, ku u vlerësua me mirënjohje për arritjet e saj në alpinizëm dhe për promovimin e Kosovës në majat më të larta të botës, përfshirë

Himalajat. Në një bashkëbisedim frymëzues, u diskutua për zhvillimin e agroturizmit dhe potencialin rekreativ të Rahovecit, si dhe për projektin ndërkufitar IPA që po zbatohet në fshatin Zoqishtë. U shpreh gatishmëria për bashkëpunim në drejtim të shndërrimit të Rahovecit në një destinacion atraktiv turistik.

203 STUDENTË DHE 50 NXËNËS PËRFITUES TË BURSËS KOMUNALE



Komuna e Rahovecit ka ndarë këtë vit një numër rekord bursash për studentë dhe nxënës. Në një takim të veçantë, u nënshkruan kontratat për 203 studentë dhe 50 nxënës nga shkollat e mesme dhe IAAP-ja, që do të përfitojnë bursën komunale për vitin akademik e shkollor në vijim. Kryetari theksoi rritjen e vazhdueshme të numrit të bursave që nga viti 2018 dhe u zotua për mbështetje të vazhdueshme për të rinjtë e komunës.



Nënshkruhet Kontrata me Shoqatën “HAREJA”

Komuna e Rahovecit ka nënshkruar kontratë bashkëpunimi me Shoqatën për Persona me Nevoja të Veçanta “Hareja”, për të mbështetur aktivitetet e saj të përditshme me gra dhe fëmijë me nevoja të veçanta. Kjo marrëveshje garanton mbështetje financiare për zhvillimin e shërbimeve sociale dhe përkrahjen e familjeve në nevojë, duke dëshmuar angazhimin institucional për mirëqenien e komunitetit.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •



Shpalosën pllaka përkujtimore në tri shtëpi-strehë të UÇK-së

Në prag të 26-vjetorit të çlirimit të Rahovecit, u shpalosën pllaka përkujtimore në tri shtëpi-strehë të UÇK-së: te familja e Haxhirizan (Ukë) Fetahut dhe Sahit Hasanit në Celinë, si dhe te familja e Smajl e Gjylie Durakut në Krushë të Madhe. Këto familje dhanë kontribut të çmuar në strehimin dhe mbështetjen e luftëtarëve të lirisë, duke u bërë pjesë e historisë së lavdishme të çlirimit të vendit. Përmes këtij veprimi, u nderua sakrificat e tyre dhe u riafirmua përkushtimi për shënjimin dhe ruajtjen e kujtesës historike.

PËRURUHET MUZEU “BAJRAM CURRI”

Në 100-vjetorin e vrasjes së atdhetarit Bajram Curri, sot u përrua muzeu i tij në vendlindje, në Krushë të Madhe. Në prag të 26-vjetorit të çlirimit të Rahovecit, ky projekt i Komunës së Rahovecit nderon figurën e këtij tribuni të vegjëlisë dhe hero të popullit shqiptar. Muzeu, i ndërtuar mbi modelin e shtëpisë ku lindi Bajram Curri, do të shërbejë për ruajtjen e trashëgimisë patriotike dhe edukimin e brezave të rinj me frymën e luftës për liri, pavarësi e bashkim kombëtar.



Vendoset gurthemeli i kullës simbol të luftës çlirimtare

Në prag të 26-vjetorit të çlirimit të Rahovecit dhe rrethinës, sot në fshatin Retijë u vendos gurthemeli i kullës simbol të luftës çlirimtare. Retija, dikur epiqendër e operimeve të brigadave të


INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut, do të jetë së shpejti vendi ku do të ruhet dhe promovohet trashëgimia e luftës.

Kulla me tri hyrje do të simbolizojë brigadat 124 “Gani Paçarizi”, 125 dhe 126 “Hasi”, duke përfshirë hapësira për artefakte, aktivitete kulturore e përkujtimore, dhe do të bëhet një pikë e rëndësishme historike dhe edukative.

Lavdi dëshmorëve dhe luftëtarëve të lirisë!



Përmbyllet faza e parë e projektit për dokumentimin e Masakrës së Krushës së Madhe



Krushë e Madhe, 2025 – Në një ceremoni të veçantë në Muzeun e Masakrës në Krushë të Madhe, u dorëzua botimi i parë që përmbledh **200 intervista me të mbijetuarit e masakrës së marsit 1999**, e njohur si një nga mizoritë më të rënda të luftës në Kosovë.

Ky projekt, i përkrahur nga Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare, MKRS-në, Ambasadën Amerikane dhe shoqata të të mbijetuarve, ka për qëllim **ruajtjen e kujtesës historike, dokumentimin e së vërtetës dhe edukimin e brezave të rinj.**

Faza e dytë e projektit do të fokusohet në:


- Krijimin e arkivës digjitale me dëshmi dhe materiale historike
- Zgjerimin e muzeut me ekspozita multimediale
- Organizimin e aktiviteteve për edukim dhe ndërgjegjësim

Kjo nismë është dëshmi e vendosmërisë për të mos lejuar që kujtesa për krimet e luftës të zbehet me kohë

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

Është shënuar **Dita e Çlirimit të Rahovecit**, me ç'rast janë organizuar aktivitete të shumta përkujtimore, kulturore dhe artistike, me pjesëmarrjen e institucioneve komunale, përfaqësuesve të shoqërisë dhe qytetarëve.



Ka përfunduar asfaltimi i rrugës “**Xhelal Hajda – Toni**”, e cila me këtë investim ka marrë një pamje të re dhe funksionale, në shërbim të qytetarëve.

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

Në kuadër të forcimit të ndërmjet institucioneve akademike, sot Kryetari Latifi, priti Rektorin e në Prizren, Prof. Asoc. cilin u nënshkrua për mbështetjen dhe Shkollës Verore



partneriteteve strategjike publike dhe atyre i Komunës së Rahovecit, z. Universitetit "Ukshin Hoti" Dr. Mentor Alishani, me të marrëveshje bashkëpunimi përkrahjen e organizimit të Ndërkombëtare 2025

Është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit për projektin **"Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në Lagjen e Komuniteteve"**.



I është dhënë mirënjohje veprimtarit Mehmet Memqaj, bashkëvuajtës i Ukshin Hotit, në shenjë vlerësimi për kontributin dhe sakrificën e tij.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

Së bashku me qytetarët e Nagacit,u përrua parku I ri, një vend ku fëmijët mund të luajnë,të rinjët të zhvillojn aktivite dhe familjet të pushojnë.



U nënshkrua marrëveshja për mbështetjen e edicionit të ardhshëm të Festës së Vjeljes së Rrushit-Hardh, Fest 2025 I cili do të mbahet me datën 5,6 dhe 7 shtator 2025.



• • •

 MUJAJ I MËRGIMTARËVE		 KOMUNA E RANQEVIT	
PROGRAMI I AKTIVITETEVE "MUJAJ I MËRGIMTARËVE" 2025			
AKTIVITETI	VENDI	DATA	ORA
Imje çfytet e Muajt 10	Komuniteti Mërgimtar në Durrës	15 shkurt 2025	13.00
Mërgimtarë	Komuniteti Mërgimtar	17 shkurt 2025	13.00
Mërgimtarë mësues në fshat 10 muh	Palestra e Sporteve "Mërgimtarë fshat"	17 shkurt 2025	13.00
Mërgimtarë vullnetarë	Kruja e Mërgimtarëve	19 shkurt 2025	13.00
Faqja e Internetit në fshat	Kruja e Mërgimtarëve	19 shkurt 2025	13.00
Mërgimtarë mësues	Kruja e Mërgimtarëve	21 shkurt 2025	13.00
Mërgimtarë mësues në shërbim të mërgimtarëve dhe të mësuesve	Kruja e Mërgimtarëve	23 shkurt 2025	13.00
Faqja e Internetit vullnetar dhe në shërbim	Kruja e Mërgimtarëve	25 shkurt 2025	13.00
Faqja e Internetit	Kruja e Mërgimtarëve	27 shkurt 2025	13.00
Të rinjtë në fshat 10 muh (17.04.2025)	Palestra e Sporteve "Mërgimtarë fshat"	19 shkurt 2025	13.00
Aktiviteti "Mërgimtarë"	Faqja e Internetit	21 shkurt 2025	13.00
Aktiviteti Komuniteti në Durrës "Faqja e Internetit"	Komuniteti Mërgimtar në Durrës	23 shkurt 2025	13.00
Aktiviteti e "Faqja e Internetit"	Kruja e Mërgimtarëve	25 shkurt 2025	13.00
Çfytet "Mërgimtarë"	Kruja e Mërgimtarëve	27 shkurt 2025	13.00
Aktiviteti në Durrës	Kruja e Mërgimtarëve	29 shkurt 2025	13.00
Aktiviteti me 10 muh e Komunitetit 10 shkurt	Kruja e Mërgimtarëve	31 shkurt 2025	13.00
Aktiviteti e Komunitetit	Kruja e Mërgimtarëve	31 shkurt 2025	13.00

A red and white LIKA Mercedes-Benz truck is driving on a cobblestone street, spraying water from its side nozzles. The truck has 'LIKA' written on its side and front. The street is lined with buildings and trees, and the sky is blue with some clouds.

26

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



U përurua murrana e **Gani Pacarizit 'Reziku'** në praninë e familjarëve të dëshmorëve, bashkëluftëtarëve, qytetarëve dhe përfaqësuesve të institucioneve u nderua jeta dhe vepra e Gani Pacarizit, përmes murranës përkujtimore, një shenjë që nuk është vetëm përkujtim, por edhe udhëzim për brezat e ardhshëm.



Ndërtimi i fushës sportive në ambientet e shkollës '**Milaim Krasniqi**' në fshatin Pastasel.

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



Ndërtimi dhe Instalimi I sistemeve bio – septike.



Në funksion të përmisimit të kushteve më të mira sanitare dhe mbrojtjen e mjedisit, po përfundojnë punimet në projektin e financuar nga **Bashkimi Europian 'Be Clean, Be Green'** për ndërtimin dhe instalimin e sistemeve bio – septike në gjashtë vendbanimet rurale të komunës sonë.

Përfitues janë 3.500 banorë.



Riasfaltimi I Rrugës '**Bekim Isma**' kjo rrugë 1 km do të pajiset me sinjalistikë vertikale dhe horizontale, në përputhje me rregullat e komunikacionit, si dhe me pengesa rrugore sipas kërkesave të qytetarëve.

INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •

Në kuadër të aktiviteteve është dhe **AGROFESTA** festival që i dedikohet perimekulturës, është bërë shumë i rëndësishëm për të gjithë bujqit në Krushën e Madhe, Rahovec, por edhe më gjerë, i cili mbahet në kuadër të muajit të mërgimtarëve.



Dekorata për humanizëm **Dr. Ali Sokoli** i jepet prof dr. **Samedin Haxhijaha**, pas vdekjes

Kjo dekorate u jepet atyre që me përkushtimin e tyre kanë ndikuar në përmisimin e jetës dhe kushteve të punës për njerëzit në nevojë.




INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECI



Kryetari Smajl Latifi priti në takim komandantin e KFOR-it Italian për Rajonin e Perëndim kolonel **Lorenzo Magnia**. Biseda u përqendrua te siguria,forcimi I bashkëpunimit dhe mbështetja në projekte për qytetarët tanë.



Në kompleksin përkujtimor të dëshmorëve të kombit në Gradish është bërë hapja e fesstivalit **FARDI Fest 2025**. **FARDI Fest** është më shumë se një festë, është një mesazh I fortë se ruajtja e vlerave tona kombëtare është një mission I përbashkët që na përket të gjithëve.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •



Në sallën e Kuvendit Komunal, në prani të përfaqësuesve të institucioneve publike lokale, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të mbijetuarave të Torturës dhe dhunës seksuale, si dhe ndalimin e stigmës si një damkë shoqërore qëë I ka përcjellur të mbijetuarit për gjithë këto vite.

Kryetari Smajl Latifi mirëpriti Amasadorin e Britanisë në Kosovë SH.T.Z. Jonathan Hargreaves.

Biseda u fokusua tek projektet që po zhvillohen në komunën tonë, për nevojat që ka Rahoveci, për rolin pozitiv të shtetit britanik në Kosovë dhe në komunë, si dhe për forcimin e partneritetit me Ambasadën Britanike.



HARDHFEST FESTA E VJELJES SË RRUSHIT

Për tre ditë e netë të paharrueshme u mbajt Festivali i vjeljes së rrushit Hardh Fest 2025, duke bashkuar nën ritet e traditës dhe tingujve të muzikës, vreshtarët, prodhuesit e verës dhe rakisë, bujqit, artistët, krijuesit e rinj dhe vizitorët nga mbarë Kosova, rajoni e bota.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

• • •



Rahoveci bëhet me internet Publik falas.

Është bërë përrurimi i fushës së re sportive dhe modern tek Shkolla fillore 'Sakip Bellaqa' në Pataqan të Epërm.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECI



Festa e 28 Nëntorit

Aktivitetet për shënimin e 28 Nëntorit nisën me pritjen zyrtare të mysafirëve, ngritjen solemne të flamurit kombëtar dhe homazhe në nderim të figurave historike.”



Vendosja e pllakës përkujtimore në shtëpinë strehë të UÇK-së

Hoca e Vogël ka qenë bazë e rendësishme në cdo periudhë,poashtu edhe ne periudhën e UÇK-së vend ku u zhvilluan ngjarje që i dhanë kuptim historisë sonë.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT


• • •

Në Ditën e Biblotekës Komunale ‘Sulejman Krasniqi’ u kujtua jeta dhe vepra e këtijë shkrimtari dhe atdhetari të madh, i cili me penën dhe me përkushtimin e tij i dha frymë dhe zemër dashurisë për atdheun.



Përrurimi I punimeve të renovimit të tërësishëm tek objekti I Shoqatës së Pavarur të Gruas ‘HAREJA’

Renovimi i këtij objekti Brenda dhe jashtë, si dhe oborrit, krijon kushte bashkëkohore dhe të sigurta për fëmijët me nevoja të vecanta, duke ofruar hapësirë të rehatshme për edukim, terapi dhe aktivitete ditore.



INFORMIM RRETH AKTIVITETEVE DHE PROJEKTEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



Sh.T.Z BAJRAM BEGAJ VIZITON RAHOVECIN

Kryetari I Komunës Smajl Latifi, në shoqërimin e bashkëpunëtorëve priti në takim Presidentin e Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z Bajram Begaj, bashkë me kabinetin e tij, në shoqërimin e Sh.T.Z Petrit Malaj, Ambasador I Republikës së Shqipërisë në Kosovë.



PËRFAQËSUESI I FONDACIONIT 'MAARIF' U PRIT NGA KRYETARI LATIFI

Biseduan për punën që po zhvillojnë në institucionet arsimore në Prishtinë dhe Prizren, nga niveli parafillor deri tek arsimimi I mesëm.



Përfundim

Edhe pse fusha e qeverisjes së mirë është mjaft e gjerë, një aspekt i rëndësishëm i saj, që është i pashmangshëm për ta plasuar qytetarin në vend qendror, është liria e informimit. Informacioni është themeli i qeverisjes së mirë, jo vetëm sepse e rrit efikasitetin, por gjithashtu sepse i fuqizon qytetarët dhe mundëson shpërndarje të barabartë të përfitimeve nga zhvillimi i përgjithshëm në vend, andaj duke dashur që të jetë sa më transparente me publikun, Komuna e Rahovecit, përmes këtij dokumenti, ka ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve të saj, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njohin e të vlerësojnë punën e institucioneve komunale.

Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është kriter bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë, të cilin duhet respektuar njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Komuna e Rahovecit ka vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikojë në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Përveç konsultimit dhe komunikimit, këto dokumente forcojnë lidhjet e qytetarëve me komunën dhe rrisin besimin që e gëzojnë zyrtarët publik në nivel lokal.

Rahovec, Dhjetor 2025.